

Prot. 2206/110K Nr

Datë. 16/06/2022, Tiranë

Drejtuar: Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Z. Ilirjan CELIBASHI

Lënda:

Kërkesë për vendosjen e sanksioneve, në zbatim të ligjit, ndaj subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve të partive politike, garues në Zgjedhjet Parlamentare të 25 prillit 2021, për shkelje të kryera prej tyre në raport me financimin e fushatës zgjedhore.

Baza Ligjore:

- Ligji Nr. 10019 datë 29.12.2008 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë,
- Vendimi nr. 9 datë 09.03.2021 i Komisionit Rregullator "Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre".

I nderuar zoti Komisioner,

Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK Albania) ka si mision mbrojtjen dhe garantimin e lirive e të drejtave të njeriut, si dhe të dimensionit të plotë të sigurisë njerëzore nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës, qeverisjes demokratike, nxitjes së aktivizmit e të angazhimit qytetar si dhe nxitjes për përgjegjshmëri, transparencë e llogaridhënie të plotë të institucioneve publike dhe politike.

Përpos përvojës së monitorimit të proceseve zgjedhore prej miratimit me referendum të Kushtetutës, KRIIK, pas reformës zgjedhore të korrikut 2012, ka nisur e ndërtuar edhe një përvojë monitorimi të pandërprerë në ndjekjen e proceseve politiko-institucionale, të cilat afektojnë drejtpërsëdrejt apo indirekt integritetin e proceseve zgjedhore, duke ofruar me një qasje analitike rekomandime apo sugjerime për një ligjzbatim sa më të plotë, në gërmë dhe në frymë të parimeve kushtetuese për sigurimin e këtij integriteti.

Nën këtë qasje, një monitorim i pandërprerë, prej tetorit 2012 e deri më sot, i është kushtuar vendimmarrjes, sjelljes dhe veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në administrimin e procesit, si dhe sjelljes dhe ligjzbatueshmërisë prej administratës së KQZ-së. Veçanërisht i është kushtuar vëmendje dhe është monitoruar në mënyrë të pandërprerë financimi i fushatave zgjedhore dhe i partive politike, raportimi i kryer prej këtyre të fundit, si dhe sjellja e vendimmarrja e KQZ-së në raport me të.

Sikurse jeni në dijeni, procesi i Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Prillit 2021, u monitorua prej KRIIK prej shtatorit 2020, me shpalljen e datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës, deri më janar 2022 me përmbylljen e tërë elementëve të një procesi zgjedhor. Gjetjet dhe rekomandimet janë bërë publike nëpërmjet raporteve e deklaratave në vazhdimësi të procesit, si dhe në Raportin Përfundimtar të publikuar në 16 shkurt 2022.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Në konsideratën e KRIIK, transparenca dhe kontrolli i financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore mbetet një çështje dhe sfidë madhore, e cila në kontekstin e gjendur, është jetike për sigurinë dhe të ardhmen demokratike të vendit.

Nga monitorimi i kryer lidhur me këtë çështje në zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021, KRIIK evidenton nevojën dhe domosdoshmërinë e vendimmarrjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve lidhur me shkeljet ligjore të evidentuara.

Kjo vendimarrje nevojitet të ndërmerret jo si një qëllim penalizues më vete, por si një detyrim ligjor i qartë, në përmbushje të rolit dhe klimës së zbatueshmërisë së ligjit prej institucioneve të pavaruara, si dhe të rritjes së përgjegjshmërisë së aktorëve politikë për zbatimin dhe respektimin e ligjit.

Sugjerohet gjithashtu që, përpos vendimmarrjes së sanksioneve ligjore të parashikuara në rastet e shkeljeve të konstatuara dhe provuara, KQZ të tërheqë vëmendjen publikisht ndaj partive politike dhe kandidatëve për përmbushjen në mënyrë të plotë të detyrimeve ligjore të parashikuara, si dhe të advokojë për nevojshmërinë e amendimeve ligjore që duhen ndërmarrë nga ligjvënësi për ta bërë eficient dhe më të plotë mekanizmin e transparencës dhe kontrollit në dispozicion.

Në kuadër të gjithë sa më sipër dhe bazuar në Vendimin nr. 9 datë 9 Mars 2021 të Komisionit Rregullator, i cili detajon përcaktimet e nenit 92/5 të Kodit Zgjedhor, ku i jepet mundësia palëve të treta të kryejnë denoncime lidhur me shkelje të mundshme për financimin e partive politike, subjekteve zgjedhore apo kandidatëve të tyre, dhe për të cilat kërkohet t'i nënshtrohen hetimit administrativ prej Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, KRIIK ju parashtron më poshtë, si indicie apo denoncim, konstatimet e tij gjatë monitorimit të hollësishëm që është kryer. Për efekt lehtësie referimi, materiali në vijim paraqitet i numërtuar.

A. KONSTATIME TË PËRGJITHSHME

- 1) Raportet e vetëdeklarimit financiar të subjekteve zgjedhore, si prej partive politike apo edhe prej kandidatëve të përfshirë në listat e tyre apo të pavarur, duhet të plotësohen me përgjegjshmëri maksimale në çdo fushë dhe detaj të përcaktuar në përmbajtjen e formularëve përbërës.

Toleranca e treguar nga KQZ-ja për pranimin e raporteve të plotësuara pjesërisht apo totalisht të paplotësuara, qoftë kjo për shkak të një qasje mirëkuptuese në kufijtë e shkeljes së ligjit, apo edhe të një mungese aftësie kontrolli paraprak nga administrata, duhet të reflektohet së paku me tërheqje vëmendje publike nga KQZ ndaj subjekteve politike në ruajtje të frymës së zbatueshmërisë së ligjit. Sikurse nevojitet gjithashtu, edhe një proces vlerësues dhe përmirësues i kapaciteteve dhe aftësive të administratës respektive përgjegjëse në KQZ.

E njëjta qasje vlen edhe për raportet e monitoruesve financiarë dhe të auditëve ligjorë.

- 2) Në vendimmarrjen e saj, KQZ-ja duhet të shtrijë kontrollin dhe gjykimin edhe në natyrën e shpenzimeve të deklaruara nga partitë politike, sidomos tek partitë të cilat kanë përfituar fonde nga buxheti i shtetit.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Sipas Kodit Zgjedhor, neni 2 pika 28, “*Shpenzime të fushatës zgjedhore*” janë shpenzimet e bëra nga ose në emër të një subjekti zgjedhor, përfshirë kandidatët dhe/ose degët e tij, ose të një kandidati të pavarur, të cilat kryhen për të promovuar fushatën e vet ose për të dëmtuar fushatën e një subjekti tjetër, përfshirë kandidatët e tij, pavarësisht datës se kur janë kryer.”

Duke qenë se Kodi Zgjedhor e përkufizon në mënyrë eksplicite shpenzimin për fushatë si një shpenzim të partisë apo kandidatit për qëllime të fushatës zgjedhore, pavarësisht datës se kur është kryer, deklarimet për pagesa të detyrimeve të prapambetura të partive apo të shpenzimeve që nuk lidhen me fushatën, duhet të mos llogariten në pasqyrat financiare të fushatës zgjedhore të tyre.

- 3) Në të njëjtën logjikë dhe bazuar në të njëjtat parime të përfitimit të fondeve dhe dhurimeve për kryerjen e fushatës elektorale prej partisë apo kandidatit, duhet konsideruar dhe trajtuar rasti i çdo subjekti, i cili përfiton fonde, qofshin këto edhe private, por që nuk arrin t’i shpenzojë ato për qëllim të fushatës.
- 4) Të ardhurat dhe shpenzimet e secilit subjekt janë në funksion të kryerjes së fushatës elektorale, fushatë e cila ndodh dhe realizohet në tërë komponentët e saj përpara datës së zgjedhjeve, pra përpara datës 25 prill 2021.
Duhet të konsiderohen shkelje, të trajtohen si të tilla dhe të mos konsiderohen si pjesë e raporteve financiarë, të gjitha veprimet financiare të cilat janë të pasqyruara në fatura me datë lëshimi pas përfundimit të procesit zgjedhor, pra pas datës 25 prill 2021. Sillet në vëmendje se këto deklarime janë në shkelje të procedurave tatimore, pasi, sipas [Udhëzimit Nr.24 datë 02.09.2008](#) “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i Ministrit të Financave, ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4, datë 25.01.2014, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 6 datë 30 janar 2014, pika 51.1 “*Shitësi lëshon faturë tatimore dhe blerësi duhet ta kërkojë atë në kohën e realizimit të shitjes apo të kryerjes së punimit ose shërbimit*”.

B. SHKELJE TË EVIDENTUARA TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

B.I. - Kategoria e parë e shkeljeve konsiston në shkelje eksplicite të ligjit, referuar të dhënave faktike të raporteve të vetëdeklarimit të subjekteve zgjedhore.

- 5) Katër parti politike, Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Balli Kombëtar, Partia Balli Kombëtar Demokrat dhe Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë, dorëzuan në KQZ raporte jashtë formatit të miratuar nga KQZ, shkelje e cila sanksionohet me gjobë sipas nenit 173, pika 3 të Kodit Zgjedhor “*...Paraqitja e raporteve në shkelje të rregullave dhe formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë nga 500 000 deri 1 000 000 lekë.*”
- 6) Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar dorëzoi raportin e vetëdeklarimit financiar në datën 11 tetor 2022 në tejkalim të afatit ligjor.
Kjo shkelje ligjore sanksionohet me masë administrative gjobë sipas përcaktimeve të nenit 173 pika 3 të Kodit Zgjedhor “*...Mosparaqitja e një*

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

raporti financiar për fushatën brenda afatit ligjor dënohet me një gjobë prej 2 000 000 lekësh.”

- 7) Kandidatët e pavarur ose të propozuar nga partitë politike apo koalicionet, mbartin të njëjtat detyrime apo kufizime në aspektin e financimit sikurse vetë subjektet zgjedhore që i propozojnë ato. Përpos partisë çdo kandidat që merr pjesë në zgjedhje duhet të dorëzojë raport vetëdeklarimi financiar ku përfshihen të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara prej tij në funksion të fushatës. Për zgjedhjet e vitit 2021, rezulton se 1,166 kandidatë nuk kanë përmbushur detyrimin ligjor të dorëzimit të këtij raporti. Lista e plotë e kandidatëve të cilët nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi ndodhet në Lidhjen Nr. 1 bashkëlidhur kësaj kërkesë.
Sipas pikës 3 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor “...Mosparaqitja e një raporti financiar për fushatën brenda afatit ligjor dënohet me një gjobë prej 2 000 000 lekësh.”
- 8) Dy parti politike, një kandidat i pavarur, dhe një numër i konsiderueshëm kandidatësh në listat shumëemërore të subjekteve, sipas Lidhjes Nr. 2 bashkëlidhur kësaj kërkesë, në shkelje të pikës 2 të nenit 92/2 të Kodit Zgjedhor kanë deklaruar pranimin e dhurimeve me vlerë më të madhe se 50.000 lekë të realizuar me para në dorë.
- 9) Përpos kandidatëve që e kanë të përcaktuar marrjen e shumave me para në dorë, ka edhe një numër të konsiderueshëm të kandidatëve të cilët nuk e kanë specifikuar mënyrën e marrjes së këtyre dhurimeve, sipas Lidhjes Nr. 3 bashkëlidhur kësaj kërkesë. Në kushtet kur ky element nuk është audituar nga auditët përkatës, KQZ do duhet të verifikojë nëse në rastet në fjalë ka shkelje të përcaktimeve të ligjit.
- 10) Gjithashtu pika 3 e neni 92/2 të Kodit Zgjedhor përcakton detyrimin e kandidatëve për të hapur dhe publikuar, nëpërmjet dorëzimit në KQZ, të llogarisë së posaçme bankare. Po sipas kësaj pike “...Kandidati i subjektit zgjedhor nuk mund të përdorë asnjë llogari tjetër bankare, përveç atyre të deklaruara, për pranimin e dhurimeve për fushatën zgjedhore, qoftë edhe për shuma më të vogla se 50 mijë lekë.”
Referuar llogarive të publikuara në faqen e internetit të KQZ-sw, rezulton se vetëm 35 kandidatë të listave shumëemërore kanë deklaruar numrin e llogarisë. Edhe për këta kandidatë nuk është e qartë nëse llogaria e publikuar është një llogari e hapur posaçërisht për fushatë apo llogari normale e tyre, pasi auditët nuk e kanë përfshirë këtë pjesë në raportet e tyre.
- 11) Nga ballafaqimi i të dhënave në raportet e vetëdeklarimit të kandidatëve dhe llogarive bankare të deklaruara, rezulton se 72 kandidatë, sipas Lidhjes Nr. 4 bashkëlidhur kësaj kërkesë, kanë pranuar dhurime të deklaruara nëpërmjet llogarisë bankare, por nuk kanë depozituar në KQZ numrin e kësaj llogarie sipas kërkesave të ligjit.
- 12) Subjektet zgjedhore: a) Partia Bindja Demokratike ka deklaruar 8 dhurues me shuma përkatësisht nga 100.000 lekë secili të kryera me para në dorë; b) Partia Lëvizja për Ndryshim ka deklaruar 4 dhurues me shuma përkatësisht nga 75.000

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

lekë secili të kryera me para në dorë; dhe c) kandidati i propozuar nga zgjedhësit z. Pal Shkambi, ka marrë dhurim në para nëpërmjet kompanive të transfertave ndërkombëtare të parave shumën 102.000 lekë.

Sipas pikës 5 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor “... *Pranimi i fondeve private më vlerë më të madhe se 50 mijë lekë përmes formave të tjera, të ndryshme nga kalimi në llogarinë bankare, dënohet me një gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe në kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së.*”

13) Bilanci i aseteve dhe detyrimeve, i cili është gjithashtu detyrim i partive për ta dorëzuar në KQZ, rezulton një detyrim i pa përmbushur. Duke qenë se është një raport që plotëson raportin e vetëdeklarimit të partive politike, duhet të trajtohet si i barazvlefshëm edhe në gjykimin për masat përkatëse administrative.

14) Neni 7 pika 2 i Vendimit nr. 13, datë 06.04.2021 të Komisionit Rregullator përcakton se financieri i partisë nuk duhet të jetë kandidat në zgjedhje. Ky përcaktim ligjor rezulton të mos jetë zbatuar nga gjashtë subjekte zgjedhore sipas listës në Lidhjen Nr. 5 bashkëlidhur kësaj kërkesë. Shqyrtimi i masës së sanksionit administrativ në këtë rast duhet të gjykohet sipas përcaktimeve të Kreut XIII të Kodit Zgjedhor. Vlen të theksohet se kjo shkelje i atribuohet si partisë politike, ashtu edhe vetë financiarit të partisë.

15) Tejkalmi i kufirit maksimal të shpenzimeve nga Partia Socialiste me rreth 4.5 milionë lekë shton nevojën e sanksionimit sipas parashikimit të Nenit 92/2, pika 4 e Kodit Zgjedhor.

Sipas pikës 9 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor përcaktohet se “...*Shkelja e kufirit maksimal të shpenzimeve nga një subjekt zgjedhor dënohet me një gjobë prej 5 000 000 lekësh ose me një gjobë të barabartë me shumën që ka kaluar kufirin, cilado që është më e lartë.*”

16) Tri parti politike kanë shpenzuar më pak se shuma e përfutur prej buxhetit të shtetit. Konkretisht: a) Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar ka përfutur nga buxheti i shtetit 1.434.012 lekë dhe ka shpenzuar 1.378.845 lekë (diferenca 55.167 lekë); b) Partia Socialdemokrate ka përfutur nga buxheti i shtetit 1.629.360 lekë dhe ka shpenzuar 0 lek (diferenca 1.629.360 lekë); c) Partia Fryma e Re Demokratike ka përfutur nga buxheti i shtetit 2.188.832 lek dhe ka shpenzuar 1.703.500 lekë (diferenca 485.332 lekë).

Sipas pikës 7 të nenit 88 të Kodit Zgjedhor “... *Në rast se shuma e përllogaritur në pikën 5 të këtij neni është më e lartë se totali i shpenzimeve të fushatës zgjedhore të raportuara nga partia politike ose është vlerësuar si e tillë nga KQZ-ja sipas auditimeve të pavarura apo verifikimeve të saj, atëherë partia politike është e detyruar të kthejë diferencën në KQZ.*”

Sanksioni administrativ, në rast mos zbatimi të detyrimit të mësipërm, plotësohet më tej me parashikimin e bërë në pikën 8 të këtij neni “... *Në rast se partia politike nuk zbaton përcaktimin e bërë në pikën 7 të këtij neni, atëherë përjashtohet nga e drejta për të përfutur fonde publike për një periudhë jo më pak se 5 vjet, përveçse kur shlyen detyrimin bashkë me gjobat.*”

17) Në shkelje të pikës 2 të neni 92/6 të Kodit Zgjedhor Partia Kombëtare Konservatore Albania nuk ka bashkëpunuar me auditin ligjor, i cili ishte

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

kontraktuar nga KQZ për auditimin e fondeve të fushatës zgjedhore të këtij subjekti.

Edhe auditi i subjektit Partia Demokratike referon në raportin e tij se nuk i janë vënë në dispozicion nga ky subjekt raportet e vetëdeklarimit të kandidatëve të saj.

Sipas pikës 2 të nenit 173 të Kodit Zgjedhor “...*Pengimi ose mosbashkëpunimi i subjektit zgjedhor me audituesin e KQZ-së dënohet me një gjobë nga 2 000 000 deri 3 000 000 lekë, si dhe me pezullim të financimit publik të partisë politike deri në 5 vjet.*”

18) Limiti i pagesave që mund të kryhen me para në dorë përcaktohet nga aktet nënligjore në fuqi në shumën maksimale prej 150.000 lekë.

Partia Socialiste ka kryer pagesë me para në dorë të një fature me vlerë më të lartë se ajo që përcakton ligji për t’u kryer *cash*, konkretisht të një fature me vlerë 311.654 lekë. Partia Lëvizja për Ndryshim, ka likuiduar një faturë me vlerë 515.425 lekë pa specifikuar mënyrën e kryerjes së pagesës. Gjithashtu 6 kandidatë të Partisë Socialiste, sipas Lidhjes Nr. 6 bashkëlidhur kësaj kërkesë, kanë kryer pagesa të tilla *cash*.

Udhëzimi Nr. 24 datë 02.09.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4, datë 25.01.2014 të Ministrit të Financave, pika 59.1.1 përcakton se “...*Ne zbatim të pikës 1 të nenit 59 të Ligjit, personat e tatueshëm nuk mund të kryejnë midis tyre transaksione shitjeje dhe blerjeje me lekë në dore, kur vlera e çdo transaksioni është më e madhe se 150 mijë lekë. Kryerja me lekë në dorë dhe jo nëpërmjet kalimit nga llogaria likuiduese e blerësit në llogarinë likuiduese të shitësit e transaksioneve të shitblerjes që e kalojnë vlerën 150 mijë lekë, përbën shkelje si për shitësin ashtu dhe për blerësin dhe dënohet, sipas nenit 120 të Ligjit me një gjobe sa 10 për qind e vlerës së çdo transaksioni të kryer me lekë në dorë.*”

B.II. - Kategoria e dytë e shkeljeve konsiston në kryqëzimin e të dhënave të raportuara nga subjektet me të dhëna të mbledhura nga aktorë të tretë të besueshëm institucionalë, të cilat edhe KQZ jo vetëm mund t’i disponojë, por, në dijeni të KRIIK, ka nisur tashmë një proces verifikimi. Konkretisht në këtë pikë përfshihen shpenzimet për Media dhe Media Sociale.

19) Pagesat e kryera tek operatorët mediatikë dhe pagesat e kryera për efekt reklamimi në mediat sociale janë zëra që mund të verifikohen nëpërmjet kryqëzimit me informacionin e operatorëve të tretë institucionalë, të besueshëm. Nëpërmjet marrjes së këtij informacioni, sikurse mund ta bëjë çdo aktor i interesuar, KRIIK ka bërë të mundur kryqëzimin e këtyre të dhënave me të dhënat e deklaruara nga subjektet zgjedhore. Pas këtij procesi është arritur në përfundimin se të dhënat e deklaruara nga subjektet me ato të marra nga burimet e treta, nuk janë të njëjta. Në të dyja këto raste kemi të bëjmë, së paku, me mosdeklarim të shpenzimeve.

20) KRIIK ka kryer një përlllogaritje të përafërt të kostove që kanë patur partitë për reklamimin në media duke patur si të dhëna bazë tarifat e reklamave të publikuara prej tyre në faqen e KQZ-së, si dhe minutat e reklamave të raportuara nga AMA.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

21) Të dhënat janë përlogaritur dhe duhen shqyrtuar duke patur në konsideratë dy rrethana të rëndësishme, të cilat i ndikojnë shumat në fjalë, dhe që në rastin konkret rezultojnë të pasqyrojnë minimumin e shumës që përbën diferencën midis deklarimeve të shpenzimeve prej subjekteve dhe shpenzimeve faktike të konsideruara të kryera pranë OSHMA-ve.

22) Rrethana e parë lidhet me faktin që 21 media (OSHMA) nuk kanë depozituar në KQZ tarifata zyrtare të reklamave, në shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 84, pika 5 të Kodit Zgjedhor. Ndërkohë që po këto OSHMA, lista e të cilave gjendet në Lidhjen Nr. 7 bashkëlidhur kësaj kërkesë, kanë transmetuar reklama.

KRIIK ka kryer përlogaritjet respektive, duke konsideruar koston për njësi të reklamës shifrën më të ulët të deklaruar në KQZ nga OSHMA-të e tjera, e që konkretisht llogaritet të jetë 1000 lekë. Nga përlogaritjet për këto 21 OSHMA rezulton një shumë totale e shpenzuar për reklamë prej 258.804.600 lekësh, sipas Lidhjen Nr. 8, bashkëlidhur kësaj kërkesë.

23) Rrethana e dytë lidhet me paqartësinë që ka KRIIK nëse shuma e deklaruar tek shpenzimet nga subjektet zgjedhore është shuma faktike e paguar apo shuma e pasqyruar në faturën e OSHMA-së, ku kjo e fundit përfshin edhe kohën falas të reklamës së vënë në dispozicion sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 84 të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit media *detyrohet që gjysmën e kohës totale të reklamës t'ua vënë në dispozicion falas subjekteve zgjedhore.*

Në çdo rast, theksohet se totali në para, që rezulton si diferencë midis asaj që deklarohet prej subjekteve zgjedhore dhe asaj që rezulton e shpenzuar nga OSHMA-të, në përlogaritjet e referuara nga KRIIK, rezulton të jetë vlera minimale.

Referuar përlogaritjeve të kryera rezulton një diferencë prej së paku 953.853.957 lekësh e padeklaruar. Të gjitha përlogaritjet e kryera, lista e subjekteve zgjedhore që kanë bërë ose jo reklamë, dhe që i kanë deklaruar ose jo ato në raportimet e dorëzuara, së bashku me vlerat përkatëse në lekë, gjendet në Lidhjen Nr. 9, tabela 9.1 dhe tabela 9.2 bashkëlidhur kësaj kërkesë.

24) Lidhur me rolin dhe sjelljen e OSHMA-ve gjatë fushatës elektorale, një element që duhet të merret në konsideratë dhe në shqyrtim nga KQZ-ja, janë pagesat e deklaruara të kryera ndaj OSHMA-ve nga disa subjekte zgjedhore, për të cilat faktohet se nuk është transmetuar reklamë nga këto OSHMA për subjektin pagues në fjalë. Një ndër këto raste është pagesa e deklaruar në raportin e kandidatit Lavdim Krasniqi të Partisë Socialiste, për emisionin “Kandidati” në Top Channel.

Në situatën kur AMA nuk realizon monitorim cilësor por vetëm sasior të transmetimeve të OSHMA-ve, konkludohet se kemi të bëjmë me një reklamë politike të paguar, por të pa specifikuar nga media si e tillë në kohën e paraqitjes dhe transmetimit për publikun.

Në këtë kontekst, vlerësohet dhe sugjerohet që KQZ-ja të thellohet më tej për të kuptuar arsyen e këtyre pagesave, jo vetëm në funksion të sigurimit të transparencës, por edhe të integritetit të këtyre problematikave në reflektime/propozime konkrete për amendime të menjëhershme ligjore.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

- 25) Në kryqëzimin e të dhënave të realizuar për të verifikuar reklamimet në mediat sociale, theksohet paraprakisht se nuk është e qartë se çfarë konkretisht përfshihet në zërin e deklaruar për mediat sociale nga ana e subjekteve zgjedhore (partive dhe kandidatëve), pasi është e paspecifikuar. Ndërkohë që në kontrollin e kryer nga KRIIK janë përfshirë vetëm të dhënat mbi reklamimet e bëra në *Facebook* dhe *Instagram* duke qenë se këto platforma mundësojnë publikimin dhe aksesin e lirë në shpenzimet e kryera në to. Gjithashtu në përlllogaritjen e bërë reklamuesit, të cilët kanë shpenzuar më pak se 100 dollarë amerikanë për reklama përgjatë periudhës së përmendur, janë përlllogaritur me një vlerë shpenzimi minimal prej 10 USD. Kjo pasi shpenzimet e bëra nën vlerën 100 USD nuk përcaktohen me saktësi, por me rang, duke e bërë të pamundur evidentimin e vlerës së saktë të shpenzuar.
- 26) Nga kontrolli i kësaj librarie, dhe krahasimi me informacionin që vetë subjektet kanë depozituar në KQZ nëpërmjet raporteve të tyre financiare, rezulton se 3 subjekte zgjedhore, 2 parti politike dhe një kandidat i pavarur, deklarojnë 0 shpenzime për media sociale, por sipas librarisë së reklamave në *Facebook* dhe *Instagram* rezulton që janë kryer pagesa. Konkretisht: a) - Partia Balli Kombëtar Demokrat, për faqen në *Facebook* të së cilës është paguar shuma 41.964 lekë nga individ i Fatmir Roshi, në raportin e vetëdeklarimit nuk ka përfshirë asnjë shpenzim; b) - Partia Socialdemokrate, për faqen në *Facebook* të së cilës është paguar shuma 21.596 lekë, në raportin e vetëdeklarimit nuk ka përfshirë asnjë shpenzim; dhe c) - Kandidati i pavarur Elton Debreshi, për faqen në *Facebook* të së cilit është paguar shuma 29.170 lekë, nuk e ka deklaruar këtë shpenzim në raportin e tij të vetëdeklarimit.
- 27) Rezultojnë se 69 kandidatë, sipas Lidhjes Nr. 10 bashkëlidhur kësaj kërkesë, kanë deklaruar 0 të ardhura dhe shpenzime, ndërkohë që sipas librarisë së reklamave në *Facebook* dhe *Instagram* rezulton të jenë kryer pagesa për faqet e tyre, nga vetë kandidati/ja apo nga persona të tretë.
- 28) Rezultojnë se 63 kandidatë, sipas Lidhjes Nr. 11 bashkëlidhur kësaj kërkesë, nuk kanë dorëzuar raport, ndërkohë që sipas librarisë së reklamave të *Facebook* dhe *Instagram* kanë kryer shpenzime në këto platforma.

B.III. - Kategoria e tretë e shkeljeve konsiston në kryqëzimin e informacionit me të dhëna të besueshme të mbledhura edhe nga aktorë të tretë, sikurse është KRIIK.

- 29) Në aksionin e tij të vëzhgimit, KRIIK ka patur në vëmendje identifikimin e zyrave zgjedhore në terren nëpërmjet monitoruesve të tij afatgjatë. Identifikim ky, i cili ka qenë gjithashtu në fokus edhe të monitoruesve të kontraktuar nga KQZ-ja.
- Lidhur me informacionin e disponuar mbi zyrat zgjedhore, në parantezë, sillat në vëmendje se për shkak të mangësive në shpjegime në raportet e vetëdeklarimit të dorëzuara nga subjektet zgjedhore, por edhe në kushtet e mungesës së një thellimi nga ana e auditëve, nuk është e qartë ndarja në deklarim e shpenzimit të bërë për zyrën zgjedhore midis subjektit zgjedhor dhe kandidatit të tij.

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

- 30) Duke marrë dhe konsideruar si numër të zyrave elektorale të hapura për një subjekt zgjedhor, shumën e numrit të zyrave të deklaruar nga vetë subjekti me numrin e deklaruar nga të gjithë kandidatët e vet, rezulton një diferencë e madhe krahasuar me numrin total të zyrave të vërejtura në terren, qoftë nga monitoruesit e KQZ-së e qoftë nga vëzhguesit e KRIIK. Theksohet se në pamundësi të verifikimeve të mëtejshme, në rastin e deklarimeve të dupluara kjo diferencë rritet edhe më shumë.
- 31) Numri i zyrave zgjedhore të deklaruara nga partitë politike është në total 479 zyra zgjedhore. Nga këto 426 zyra janë deklaruar nga partitë dhe 53 zyra janë deklaruar nga kandidatët.
Nga ana tjetër, rezulton se numri total i zyrave zgjedhore të evidentuara ne terren nga monitoruesit e kontraktuar nga KQZ-ja është 660 zyra, ndërkohë që sipas evidentimit të bërë nga vëzhguesit e KRIIK ky numër është 651 zyra. Pasqyrimi i detajuar i numrit të zyrave zgjedhore për secilin subjekt zgjedhor gjendet në Lidhjen Nr. 12 bashkëlidhur kësaj kërkesë.
- 32) KRIIK nxit KQZ-në për një shqyrtim të thelluar të kësaj mospërputhje si një element shumë i dobishëm e me vlerë, i cili, në një qasje analitike mbi zërat e shpenzimeve dhe kostot respektive do të jepte një panoramë më të plotë edhe të shpenzimeve reale të lidhura me mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të një zyre zgjedhore, e rrjedhimisht edhe të aktivitetit elektorale në tërësi, për këtë zë, të një partie politike.

Duke shprehur Vlerësimin dhe Konsideratën e Lartë për bashkëpunimin në vazhdimësi me Ju dhe me institucionin tuaj, mbetemi të gatshëm për çdo detaj apo informacion tjetër që mund të konsiderohet i nevojshëm.

Me Konsideratë,
Për Koalicionin për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara
(KRIIK Albania)

Premto GOGO
Kryetar

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

LIDHJA NR. 1

Lista e plotë e kandidatëve të cilët nuk kanë dorëzuar raport vetëdeklarimi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti
1	Abdyl Merkja	Tiranë	BD
2	Ada Backa	Elbasan	NTH
3	Ada Gjeshaj	Lezhë	ABEOK
4	Ada Haxhi	Tiranë	ADR
5	Adela Hysenaj	Fier	PS
6	Adela Dine	Elbasan	ABEOK
7	Adelina Teta	Dibër	PLDSH
8	Adeliona Llapushi	Fier	ABEOK
9	Adiola Canameti	Tiranë	PSD
10	Adivie Vraniçi	Durrës	ABEOK
11	Admir Tomorrow	Fier	ADR
12	Adnand Xhaferaj	Tiranë	PBK
13	Adrian Mataj	Durrës	ADR
14	Adriatik Isufaj	Fier	PBK
15	Adriatik Alimadhi	Tiranë	PBK
16	Adrijana Luzi	Durrës	PLDSH
17	Aferdita (Pushi)Gjini	Berat	PD-PD / AN
18	Aferdita Salku	Durrës	NTH
19	Aferdita Cani	Elbasan	ABEOK
20	Agim Baçi	Durrës	PD-PD / AN
21	Agim Mhilli	Lezhë	NTH
22	Agim Zyka	Fier	ABEOK
23	Agim Tomorrow	Fier	ABEOK
24	Aglenda Shametaj	Tiranë	PLDSH
25	Aglerto Bobo	Tiranë	BD
26	Agron Shehaj	Tiranë	PD-PD / AN
27	Agron Kapllanaj	Fier	PD-PD / AN
28	Agron Gjekomarkaj	Lezhë	PD-PD / AN
29	Agron Çalliku	Durrës	BD
30	Agron Shabani	Durrës	ABEOK
31	Ahmet Çaveli	Tiranë	ABEOK
32	Aida Gjini	Elbasan	NTH
33	Aida Brahilika	Tiranë	PSD
34	Ajet Biçi	Tiranë	ADR
35	Akil Sokolaj	Kukës	ABEOK
36	Alba Dervishi	Tiranë	BD
37	Alban Cani	Elbasan	ABEOK
38	Albana Çuro	Vlorë	PSD
39	Albana Tahiri	Tiranë	ADR
40	Albana Koçiaj	Tiranë	ADR
41	Alberando Kapaj	Vlorë	PBK
42	Albert Jaupi	Tiranë	PSD
43	Albi Ceno	Durrës	BD

Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti
45	Albriç Deraç	Vlorë	ABEOK
46	Aldo Karati	Tiranë	PLDSH
47	Aldo Luli	Durrës	BD
48	Aldo Rubiku	Durrës	BD
49	Aledija Unuri	Shkodër	NTH
50	Aleks Bezhani	Berat	ABEOK
51	Aleksander Kodheli	Tiranë	NTH
52	Aleksandro Biri	Durrës	ADR
53	Algert Skenderi	Tiranë	ABEOK
54	Algerta Plakaxhiu	Elbasan	NTH
55	Alida Salillari	Tiranë	NTH
56	Alket Kazerma	Korçë	NTH
57	Alketa Mukavelati	Berat	PD-PD / AN
58	Alketa Lugaj	Fier	PD-PD / AN
59	Alketa Pjetri	Lezhë	PSD
60	Alma Guma	Fier	PSD
61	Alma Muda	Durrës	ABEOK
62	Alma Ramku	Korçë	ABEOK
63	Alma Harizi	Tiranë	ABEOK
64	Alma Çuni	Elbasan	PBK
65	Almer Zyka	Vlorë	PLDSH
66	Almida Abazi	Fier	BD
67	Alta Haluci	Vlorë	PD-PD / AN
68	Altin Naçi	Berat	NTH
69	Altin Allidri	Berat	PSD
70	Altin Gjeshaj	Shkodër	ABEOK
71	Alvis Rafta	Lezhë	PLDSH
72	Amarild Sheqi	Vlorë	PLDSH
73	Amarilda Shuti	Gjirokastër	NTH
74	Amarilda Alimadhi	Tiranë	BD
75	Amarilda Lamaj	Vlorë	PBK
76	Amarildo Sallo	Vlorë	ADR
77	Ambra Mema	Tiranë	ADR
78	Amel Pervizi	Shkodër	NTH
79	Amela Zaganjori	Shkodër	PSD
80	Amina Shehu	Berat	ADR
81	Amversa Bardhaj	Shkodër	BD
82	Ana Xhelo	Tiranë	PLDSH
83	Ana Turhani	Berat	ADR
84	Anastasia Kamberi	Gjirokastër	BD
85	Andi Bevapi	Elbasan	NTH
86	Andi Demo	Fier	NTH
87	Andi Përmeti	Korçë	BD

44	Albiona Thaçi	Kukës	PSD	88	Andi Turhanaj	Fier	ADR
Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti	Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti
89	Andia Ulliri	Durrës	PD-PD / AN	133	Ardian Lazaj	Fier	BD
90	Andon Qako	Berat	ABEOK	134	Ardian Kollozi	Vlorë	BD
91	Andrea Mano	Korçë	PD-PD / AN	135	Ardian Gjuzi	Elbasan	ABEOK
92	Andreas Metushi	Korçë	ABEOK	136	Ardian Dusho	Tiranë	PBK
93	Andri Koroveshi	Tiranë	BD	137	Ardian Këllici	Shkodër	ADR
94	Anduela Ismaili	Vlorë	NTH	138	Ardiana Lala	Vlorë	PLDSH
95	Anduela Caca	Gjirokastrë	PSD	139	Ardiana Kraja	Shkodër	PBK
96	Anduen Hymeri	Korçë	ABEOK	140	Ardiana Lamaj	Vlorë	PBK
97	Anila Bishqemi	Elbasan	PD-PD / AN	141	Ardit Benja	Berat	PD-PD / AN
98	Anila Hysenbegasi	Korçë	PD-PD / AN	142	Ardit Rama	Dibër	NTH
99	Anila Bitri	Berat	PSD	143	Ardit Kola	Tiranë	NTH
100	Anila Prifti	Fier	BD	144	Ardit Kullafi	Elbasan	PSD
101	Anila Merdani	Dibër	ABEOK	145	Ardit Sina	Tiranë	PLDSH
102	Anisa Xhika	Dibër	PS	146	Ardit Shehaj	Lezhë	BD
103	Anisa Aliu	Vlorë	NTH	147	Ardit Gaçi	Durrës	ABEOK
104	Anisa Hoxha	Berat	PSD	148	Ardit Stojku	Vlorë	ADR
105	Anisa Kaloshi	Fier	PLDSH	149	Arian Samarxhiu	Elbasan	BD
106	Anisa Çako	Fier	PLDSH	150	Arife Molla	Berat	PBK
107	Anisa Saraçi	Tiranë	ABEOK	151	Arindo Lulaj	Fier	NTH
108	Anita Dervishi	Durrës	ABEOK	152	Arjan Ferko	Fier	PSD
109	Anjeza Mulleti	Durrës	PLDSH	153	Arjan Devollaj	Vlorë	BD
110	Antigona Hajdaraj	Kukës	ADR	154	Arjan Avdolli	Korçë	ABEOK
111	Antionin Halla	Fier	PBK	155	Arjan Hoxha	Tiranë	ABEOK
112	Antoneta Rustemi	Berat	BD	156	Arjan Kullolli	Tiranë	ADR
113	Antonio Jorgji	Durrës	PSD	157	Arjana Ishmi	Shkodër	PSD
114	Antonio Tarllamishi	Tiranë	PLDSH	158	Arjen Gjiriti	Korçë	BD
115	Anula Mama	Gjirokastrë	ABEOK	159	Arjeta Kasmi	Durrës	ADR
116	Anxhela Tabaku	Berat	NTH	160	Arlind Mesi	Shkodër	NTH
117	Anxhela Delibashi	Berat	NTH	161	Arlind Kasëmi	Vlorë	BD
118	Anxhela Nune	Korçë	PSD	162	Arlinda Bezhani	Berat	PLDSH
119	Anxhela Damjani	Tiranë	PLDSH	163	Arlindo Toro	Tiranë	PBK
120	Anxhela Zavalani	Tiranë	BD	164	Arlindo Vogli	Elbasan	ADR
121	Anxhela Deçka	Vlorë	ADR	165	Armand Korça	Durrës	PLDSH
122	Anxhelo Nika	Shkodër	ABEOK	166	Armandi Narta	Elbasan	ABEOK
123	Arba Sinakoli	Tiranë	ABEOK	167	Armela Murataj	Fier	ADR
124	Arben Myzeqari	Fier	BD	168	Armir Nezha	Fier	PBK
125	Arben Skënderaj	Tiranë	BD	169	Arqile Janku	Vlorë	ABEOK
126	Arbër Ndreu	Kukës	NTH	170	Arsen Belaj	Vlorë	BD
127	Arbër Roshi	Fier	ADR	171	Arsen Thikaxhija	Shkodër	PBK
128	Arbri Haxhiu	Durrës	PLDSH	172	Arsen Geci	Shkodër	ADR
129	Ardi Mugri	Shkodër	PBK	173	Arta Palushi	Shkodër	LRE
130	Ardian Zeneli	Elbasan	PD-PD / AN	174	Arta Xhari	Lezhë	PLDSH
131	Ardian Sulollari	Tiranë	NTH	175	Artan Hatellari	Berat	PLDSH
132	Ardian Nikulaj	Lezhë	PSD	176	Artan Gjinali	Tiranë	ABEOK

Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti	Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti
177	Artemis Malo	Gjirokastrë	PS	221	Besmir Stojku	Elbasan	ADR
178	Artenis Duka	Fier	BD	222	Besnik Hamitaj	Fier	PLDSH
179	Artiol Kanani	Shkodër	ADR	223	Betime Zymeri	Shkodër	PBK
180	Artjola Dervishaj	Durrës	PSD	224	Betisa Myftari	Tiranë	NTH
181	Artjola Kastrati	Durrës	PLDSH	225	Bilbil Dervishi	Shkodër	PSD
182	Artur Roshi	Tiranë	PD-PD / AN	226	Bino Abazaj	Tiranë	NTH
183	Artur Velaj	Durrës	NTH	227	Bledar Mulla	Vlorë	NTH
184	Artur Dedja	Durrës	PSD	228	Bledar Xhaferi	Korçë	PSD
185	Artur Prishtina	Durrës	PLDSH	229	Bledar Burgjia	Vlorë	BD
186	Artur Hadaj	Gjirokastrë	PLDSH	230	Bledar Velçani	Durrës	ADR
187	Artur Merdani	Lezhë	ABEOK	231	Bledar Tusha	Elbasan	ADR
188	Artur Ndreca	Lezhë	ABEOK	232	Bledar Bregasi	Korçë	ADR
189	Arturi Hoxha	Korçë	ADR	233	Bledar Paloka	Lezhë	ADR
190	Arzije Hysa	Tiranë	PLDSH	234	Bleona Qorri	Fier	ABEOK
191	Astrit Patozi	Tiranë	BD	235	Bleona Sadikllari	Durrës	PBK
192	Astrit Gjinaj	Durrës	PSD	236	Bleona Simoni	Lezhë	PBK
193	Astrit Shkëmbi	Elbasan	PBK	237	Blerina Reçi	Durrës	PD-PD / AN
194	Atird Hoxha	Vlorë	PD-PD / AN	238	Blerina Hizmo	Vlorë	BD
195	Aulona Kulluri	Tiranë	PLDSH	239	Boran Dogu	Vlorë	PSD
196	Aurel Larti	Korçë	BD	240	Borana Tartari	Tiranë	NTH
197	Aurel Çela	Elbasan	PBK	241	Boriana Durmishi	Fier	NTH
198	Aurel Kopeci	Gjirokastrë	ADR	242	Boris Shakaj	Tiranë	NTH
199	Aurel Hoxha	Tiranë	ADR	243	Bosian Lamaj	Tiranë	PSD
200	Avdi Meli	Tiranë	PBK	244	Boy King Hoxha	Vlorë	ADR
201	Azem Haliti	Vlorë	NTH	245	Briana Bino	Durrës	BD
202	Bahri Shabani	Shkodër	BD	246	Brigen Sinanaj	Fier	PLDSH
203	Bardhe Lisi	Shkodër	ABEOK	247	Brigjilda Simoni	Lezhë	PBK
204	Bardhyl Harizi	Fier	ABEOK	248	Brikena Goxheri	Dibër	BD
205	Bashkim Fino	Fier	PS	249	Brikena Zeneli	Korçë	BD
206	Basri Elezi	Kukës	PBK	250	Brunilda Dhrami	Tiranë	NTH
207	Behar Nuci	Dibër	BD	251	Bruno Xhaferaj	Vlorë	PBK
208	Belind Këllici	Tiranë	PD-PD / AN	252	Bujar Leskaj	Vlorë	PD-PD / AN
209	Benard Palaj	Lezhë	PS	253	Bujar Hoxhaj	Berat	PD-PD / AN
210	Benard Martini	Tiranë	PSD	254	Bujar Reka	Gjirokastrë	ABEOK
211	Beqir Agolli	Tiranë	ABEOK	255	Bukuri Sakolli	Tiranë	PBK
212	Bere Veseli	Dibër	PSD	256	Çlirim Gjata	Tiranë	PD-PD / AN
213	Bernard Lejthija	Shkodër	ABEOK	257	Cyme Lulaj	Tiranë	PBK
214	Berton Xhimanka	Tiranë	ADR	258	Daniel Kordhoni	Tiranë	NTH
215	Besara Ganjolla	Shkodër	NTH	259	Daniel Elezi	Tiranë	PLDSH
216	Besard Myrtaj	Vlorë	NTH	260	Daniel Alcani	Fier	BD
217	Besart Meta	Tiranë	PSD	261	Daniel Haxhiu	Fier	PBK
218	Besjana Ramaj	Fier	NTH	262	Danjel Çoku	Lezhë	NTH
219	Besjana Lushaj	Fier	PSD	263	Danjel Garunja	Tiranë	PSD
220	Besmir Sadiku	Shkodër	NTH	264	Dashmir Shehi	Tiranë	PD-PD / AN

Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti	Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti
265	Dashnor Laçi	Tiranë	ADR	309	Edi Paloka	Durrës	PD-PD / AN
266	David Velaj	Shkodër	NTH	310	Edisa Zeqo	Elbasan	BD
267	Dea Çela	Berat	NTH	311	Edison Hasanaj	Kukës	BD
268	Debora Piperi	Korçë	NTH	312	Edlir Veizi	Korçë	ADR
269	Deis Ribaj	Vlorë	NTH	313	Edlir Dado	Vlorë	ADR
270	Demokrat Nela	Kukës	BD	314	Edlira Shëngjoni	Shkodër	PLDSH
271	Denata Toçe	Korçë	BD	315	Edlira Pelinku	Shkodër	PBK
272	Denis Deliu	Durrës	PS	316	Edmir Piroviq	Shkodër	PLDSH
273	Denis Dema	Tiranë	NTH	317	Edmond Çata	Tiranë	PLDSH
274	Denis Skura	Dibër	PSD	318	Edmond Piroli	Lezhë	BD
275	Denis Preçi	Tiranë	PSD	319	Edmond Kapllani	Berat	PBK
276	Denis Molla	Tiranë	BD	320	Edmond Agolli	Tiranë	PBK
277	Denis Biçaku	Durrës	ABEOK	321	Edmond Berberi	Durrës	ADR
278	Denis Çakmashi	Tiranë	PBK	322	Edmond Ndoj	Lezhë	ADR
279	Denisa Maze	Vlorë	PSD	323	Edmond Stojku	Tiranë	ADR
280	Denisa Mbrakulli	Berat	BD	324	Edmond Isaku	Dibër	PD-PD / AN
281	Denisa Mançellari	Tiranë	PBK	325	Eduard Kola	Tiranë	NTH
282	Denisa Maletaj	Lezhë	ADR	326	Eduard Gjoka	Shkodër	PSD
283	Dëshire Agolli	Dibër	ABEOK	327	Eduart Laci	Tiranë	PBK
284	Devi Fing-ja	Tiranë	BD	328	Eduart Ndocaj	Lezhë	ADR
285	Dhionis Musollari	Berat	PLDSH	329	Eglant Toromani	Tiranë	ADR
286	Dhionis Kënini	Vlorë	ABEOK	330	Eglantina Tafa	Berat	NTH
287	Diamela Lamçe	Fier	PBK	331	Egriselda Allushi	Durrës	NTH
288	Dikanjo Doda	Shkodër	PLDSH	332	Ejona Hima	Korçë	NTH
289	Dilaver Kamberaj	Fier	PD-PD / AN	333	Ekaterina Zoto	Durrës	ADR
290	Dilaver Shala	Dibër	PBK	334	Elda Hoti	Lezhë	PD-PD / AN
291	Dionis Jorgji	Korçë	NTH	335	Elda Bajraktari	Shkodër	PLDSH
292	Donika Tushaj	Lezhë	NTH	336	Elda Pano	Durrës	BD
293	Dorela Kroni	Tiranë	NTH	337	Eldio Preçi	Durrës	PSD
294	Dorian Pali	Lezhë	NTH	338	Eldis Arapi	Fier	NTH
295	Dorian Vukaj	Shkodër	PBK	339	Elena Skenderasi	Korçë	PSD
296	Dorina Xhakollari	Gjirokastrë	PLDSH	340	Elidjon Caco	Tiranë	PBK
297	Dorjan Veseli	Dibër	PSD	341	Elio Shabani	Elbasan	NTH
298	Dorjan Hoxhaj	Lezhë	BD	342	Elis Elezi	Tiranë	NTH
299	Dorjan Demaj	Berat	ABEOK	343	Elis Rakipaj	Tiranë	PSD
300	Dorjana Petro	Korçë	PSD	344	Elisabeta Pepa	Berat	BD
301	Drilona Xhindi	Berat	ADR	345	Elizabeta Rredhi	Fier	PD-PD / AN
302	Drita Marku	Durrës	BD	346	Elizabeta Gjishti	Berat	PLDSH
303	Drita Duka	Vlorë	ABEOK	347	Elon Ciko	Tiranë	BD
304	Dritan Arapi	Tiranë	PSD	348	Elona Çapnage	Shkodër	NTH
305	Dritan Troksi	Tiranë	PBK	349	Elona Marku	Dibër	PBK
306	Dritjola Karadaku	Korçë	PLDSH	350	Elsa Cengu	Tiranë	NTH
307	Durim Çekrezi	Elbasan	PD-PD / AN	351	Elsa Voka	Berat	ABEOK
308	Dylaver Pepa	Elbasan	ABEOK	352	Elsa Biri	Durrës	ADR

Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti	Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti
353	Elsa Pajollari	Korçë	ADR	397	Enver Peqini	Fier	BD
354	Elsaveta Beqiraj	Vlorë	ABEOK	398	Enxhi Çiçaj	Vlorë	PBK
355	Elsina Gjindali	Vlorë	NTH	399	Enxhi Çausi	Elbasan	ADR
356	Eltmir Lala	Dibër	NTH	400	Era Buçpapaj	Kukës	NTH
357	Elton Çanaj	Tiranë	NTH	401	Era Stojku	Dibër	ADR
358	Elton Laçi	Tiranë	BD	402	Erald Jashari	Durrës	NTH
359	Elton Kullolli	Elbasan	ABEOK	403	Erald Kordhoni	Tiranë	NTH
360	Elton Buzani	Elbasan	PBK	404	Erald Metaliu	Tiranë	PLDSH
361	Elvi Dragoj	Durrës	NTH	405	Erald Latifi	Korçë	ABEOK
362	Elvira Abdulaj	Vlorë	PBK	406	Eralda Bano(Tase)	Fier	PD-PD / AN
363	Elvis Preçi	Lezhë	PLDSH	407	Eralda Murati	Tiranë	ABEOK
364	Elvis Dibra	Shkodër	PLDSH	408	Eraldo Hatija	Fier	NTH
365	Elvis Kondakçiu	Berat	BD	409	Erbi Ago	Tiranë	NTH
366	Emanuel Gjoka	Lezhë	PSD	410	Erda Kurti	Durrës	PLDSH
367	Emanuela Roko	Tiranë	PLDSH	411	Ergest Krakulli	Fier	PS
368	Emilja Koliqi	Shkodër	PD-PD / AN	412	Ergis Sulo	Korçë	PBK
369	Emiljana Alimadhi	Dibër	PBK	413	Ergys Leba	Durrës	PLDSH
370	Emiljano Lata	Gjirokastër	PBK	414	Ergys Musliu	Tiranë	ABEOK
371	Emiljano Përndreka	Shkodër	ADR	415	Ergys Rroga	Fier	ADR
372	Emirjan Perdoda	Shkodër	ADR	416	Eri Banushaj	Vlorë	PLDSH
373	Endri Qahalliu	Berat	PLDSH	417	Erida Zaçli	Korçë	PLDSH
374	Endri Telhallari	Durrës	PBK	418	Eridjon Alimadhi	Berat	PBK
375	Endri Kaleshi	Tiranë	PBK	419	Erind Hoxha	Tiranë	PBK
376	Endrit Shabani	Tiranë	NTH	420	Erinda Dane	Tiranë	NTH
377	Endrit Diçi	Tiranë	NTH	421	Erinda Nela	Tiranë	ABEOK
378	Endrit Bardhi	Gjirokastër	PBK	422	Eriola Hoxha	Fier	PS
379	Endrit Koçiaj	Fier	ADR	423	Eriola Toro	Fier	PBK
380	Enea Alla	Elbasan	NTH	424	Erion Murataj	Elbasan	BD
381	Enea Isufi	Berat	PSD	425	Erion Barxhani	Shkodër	ADR
382	Enea Dengeri	Durrës	BD	426	Erison Karamani	Berat	BD
383	Eneida Ruzhdije	Vlorë	PLDSH	427	Erjan Guxha	Kukës	NTH
384	Eneo Lika	Lezhë	ADR	428	Erjola Nastu	Korçë	NTH
385	Enerida Xhepollari	Durrës	PSD	429	Erjon Dervishi	Tiranë	NTH
386	Enerik Baçi	Korçë	PSD	430	Erjon Gjoka	Durrës	BD
387	Eni Madhi	Korçë	ADR	431	Erjon Toçi	Elbasan	BD
388	Enkeleda Latifi	Elbasan	ABEOK	432	Erjon Gega	Elbasan	BD
389	Enkeleda Jemin	Tiranë	ADR	433	Erjon Kaiku	Tiranë	BD
390	Enkeleida Shparthi	Fier	PLDSH	434	Erkin Qiraxhi	Durrës	BD
391	Enkelejdi Alibeaj	Fier	PD-PD / AN	435	Erla Dervishi	Korçë	ADR
392	Enkelejda Sallaku	Tiranë	PD-PD / AN	436	Ermal Muçaj	Elbasan	PSD
393	Enriko Kaçaj	Vlorë	NTH	437	Ermal Bendo	Vlorë	ADR
394	Enriko Ceko	Tiranë	ABEOK	438	Ermand Vrapit	Gjirokastër	PLDSH
395	Entela Muça	Elbasan	PSD	439	Ermelinda Meçi	Lezhë	BD
396	Enver Korro	Gjirokastër	NTH	440	Ermes Firaj	Korçë	PBK

Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti	Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti
441	Ermilda Gjini	Gjirokastrë	PSD	485	Fadil Merzheku	Elbasan	PD-PD / AN
442	Ermira Gjika	Korçë	PLDSH	486	Fanula Rustemi	Vlorë	PLDSH
443	Ermira Hupi	Dibër	BD	487	Farudin Haxhiraj	Vlorë	PBK
444	Ermira Hasa	Elbasan	ADR	488	Fatbardha Goga	Fier	PSD
445	Ernest Nikolli	Lezhë	PLDSH	489	Fatime Pepa	Berat	ABEOK
446	Erold Buzo	Korçë	PLDSH	490	Fation Kullsi	Gjirokastrë	PBK
447	Ersa Dergjini	Shkodër	PBK	491	Fatjon Deda	Tiranë	PSD
448	Ersen Bala	Shkodër	PSD	492	Fatjon Haxhiu	Tiranë	PLDSH
449	Ersi Sinani	Vlorë	ADR	493	Fatjon Leçini	Tiranë	PLDSH
450	Ersid Dobrovoda	Shkodër	NTH	494	Fatjon Doci	Tiranë	PLDSH
451	Ertigel Bardho	Berat	PSD	495	Fatjon Feka	Korçë	BD
452	Ervin Xhelo	Fier	PLDSH	496	Fatjona Zaja	Lezhë	ABEOK
453	Ervin Dyrmishi	Durrës	PBK	497	Fatma Maka	Shkodër	BD
454	Ervin Çipi	Elbasan	PBK	498	Fatmir Sinani	Tiranë	ADR
455	Ervin Kavaja	Elbasan	PBK	499	Fatos Idrizi	Elbasan	PSD
456	Ervis Rama	Elbasan	NTH	500	Fejzo Nikollari	Durrës	ADR
457	Ervis Lipi	Korçë	NTH	501	Feliks Merolli	Tiranë	NTH
458	Ervis Beu	Durrës	ABEOK	502	Fernando Xhelollari	Korçë	BD
459	Ervis Myrteza	Fier	ADR	503	Festim Zanaj	Fier	ABEOK
460	Ervis Muhaj	Fier	ADR	504	Festime Banushi	Korçë	ADR
461	Ervis Shkopi	Tiranë	ADR	505	Fetah Rusi	Dibër	PBK
462	Ervis Brahimaj	Tiranë	ADR	506	Fidel Ylli	Tiranë	PS
463	Erzen Laçi	Durrës	PD-PD / AN	507	File Telallari	Fier	PBK
464	Esin Lekiq	Shkodër	BD	508	Fjona Xhurxhi	Dibër	ADR
465	Esmë Balla	Tiranë	ADR	509	Fjorida Demko	Berat	ADR
466	Esmeralda Marfani	Lezhë	BD	510	Flamur Hoxha	Elbasan	PBK
467	Esmeralda Ndreca	Shkodër	ABEOK	511	Flamur Noka	Tiranë	PD-PD / AN
468	Esmeralda Dusho	Berat	PBK	512	Flamur Shima	Fier	PLDSH
469	Esmeralda Abazi	Elbasan	PBK	513	Flamur Alimadhi	Durrës	PBK
470	Etion Joka	Tiranë	LSI	514	Flamur Bulku	Dibër	ADR
471	Etleva Damzi	Lezhë	PLDSH	515	Flavia Nuraj	Tiranë	PSD
472	Etleva Damzi.	Lezhë	PLDSH	516	Flavio Kaziaj	Tiranë	BD
473	Euglena Liçe	Berat	NTH	517	Flogert Muça	Tiranë	PLDSH
474	Euxhes Fetahu	Tiranë	ABEOK	518	Flora Manuka	Tiranë	PSD
475	Eva Xhediku	Tiranë	NTH	519	Flora Kolaj	Elbasan	BD
476	Eva Bogdani	Elbasan	ADR	520	Flora Nika	Tiranë	ADR
477	Eva Bozha	Shkodër	ADR	521	Florenc Korra	Elbasan	BD
478	Evisa Valteri	Tiranë	PSD	522	Florian Tahiri	Durrës	PD-PD / AN
479	Fabian Topollari	Tiranë	BD	523	Florian Xeka	Tiranë	ABEOK
480	Fabio Martini	Shkodër	PSD	524	Florind Sala	Durrës	PSD
481	Fabiola Mama	Durrës	ABEOK	525	Florinda Mata	Tiranë	ABEOK
482	Fabion Dama	Durrës	ADR	526	Florjan Troka	Fier	PSD
483	Fabjol Kurti	Tiranë	PSD	527	Florjan Hyka	Durrës	PLDSH
484	Fabjola Lala	Fier	ADR	528	Florjan Skënderaj	Vlorë	PLDSH

Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti	Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti
529	Foni Haxhimihali	Berat	BD	573	Gledis Lloshi	Shkodër	BD
530	Franc Hasa	Elbasan	PSD	574	Gledis Vuksani	Tiranë	ADR
531	Frenkli Mema	Tiranë	ADR	575	Gledis Veseli	Tiranë	ADR
532	Frrok Gjini	Shkodër	PS	576	Gledjon Ahmeti	Vlorë	PSD
533	Gazmend Doda	Tiranë	PSD	577	Greta Bardeli	Shkodër	PD-PD / AN
534	Gazmir Lala	Dibër	PSD	578	Greta Uldeaj	Tiranë	BD
535	Gazmir Dauti	Durrës	PSD	579	Greta Gega	Durrës	ADR
536	Gazmir Bardhi	Shkodër	PBK	580	Grigor Palko	Korçë	BD
537	Genald Hallulli	Durrës	NTH	581	Griselda Belaj	Durrës	NTH
538	Genc Luanaj	Shkodër	PLDSH	582	Griselda Rushanaj	Fier	PSD
539	Genci Jazxhi	Korçë	PLDSH	583	Gurie Haxhillari	Korçë	PBK
540	Gent Strazimiri	Tiranë	PD-PD / AN	584	Hajdër Koxha	Berat	NTH
541	Genta Tela	Elbasan	PSD	585	Hajdër Alimadhi	Lezhë	PBK
542	Genti Lasku	Tiranë	BD	586	Hakiardo Hoxhallari	Korçë	ADR
543	Gentian Dervishi	Tiranë	NTH	587	Halil Hoxha	Fier	PBK
544	Gentian Braho	Korçë	PLDSH	588	Hamëz Gjonaj	Tiranë	NTH
545	Gentjan Muça	Tiranë	BD	589	Hamit Stema	Durrës	PLDSH
546	Gerald Rroshi	Tiranë	PBK	590	Hatem Kapllani	Fier	PBK
547	Gerald Çikani	Tiranë	ADR	591	Haxhi Raga	Durrës	PLDSH
548	Geraldo Sulkollari	Korçë	PBK	592	Haziz Peka	Dibër	ABEOK
549	Geraldo Keqira	Lezhë	PBK	593	Hekuran Alia	Gjirokastër	PSD
550	Geri Rama	Fier	PSD	594	Helga Sallaku	Shkodër	PD-PD / AN
551	Gerti Dhima	Fier	NTH	595	Henrik Hamollari	Korçë	PLDSH
552	Gertjan Deda	Tiranë	PSD	596	Hermes Dylgjeri	Elbasan	PSD
553	Gesian Xhelaj	Vlorë	PSD	597	Hermes Matraku	Durrës	ADR
554	Gezim Bazelli	Durrës	PBK	598	Hilmi Plava	Shkodër	ABEOK
555	Gëzim Ademaj	Vlorë	PD-PD / AN	599	Hristo Beqiraj	Vlorë	ABEOK
556	Gëzim Ruko	Fier	NTH	600	Hylvi Brahimi	Shkodër	PBK
557	Gëzim Boçari	Vlorë	ABEOK	601	Hyqmet Hamati	Tiranë	ABEOK
558	Gëzim Breza	Shkodër	PBK	602	Ibrahim Shabani	Elbasan	ABEOK
559	Gëzim Hysenllari	Tiranë	PBK	603	Ido Pashaj	Fier	ABEOK
560	Gëzim Kodra	Tiranë	ADR	604	Igli Cara	Durrës	PD-PD / AN
561	Gilberta Simoni	Fier	ADR	605	Igli Xhurxhi	Elbasan	ADR
562	Gino Zefi	Tiranë	ABEOK	606	Igli Aliko	Gjirokastër	ADR
563	Gjergj Piroli	Lezhë	PSD	607	Ignat Basha	Fier	PLDSH
564	Gjergj Hatellari	Tiranë	PBK	608	Igreta Sinanaj	Fier	NTH
565	Gjergji Thanasi	Durrës	ABEOK	609	Ijon Bushi	Dibër	ADR
566	Gjergji Theodhosi	Lezhë	ABEOK	610	Ilda Dhori	Fier	PD-PD / AN
567	Gjergji Nole	Tiranë	ADR	611	Ilda Buqa	Fier	LN
568	Gjovalin Laska	Lezhë	PD-PD / AN	612	Ilda Qarri	Fier	PLDSH
569	Gjovalin Dushaj	Shkodër	BD	613	Ilir Balla	Tiranë	BD
570	Gladiola Çopa	Durrës	PSD	614	Ilir Haluli	Vlorë	PLDSH
571	Gledi Kryemadhi	Tiranë	ADR	615	Ilir Saliasi	Durrës	BD
572	Gledis Çeliku	Shkodër	PSD	616	Ilir Alushi	Tiranë	ABEOK

Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti	Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti
617	Ilir Asllanaj	Tiranë	PBK	661	Jonida Gjoka	Tiranë	ABEOK
618	Ilir Visha	Tiranë	ADR	662	Jonida Kito	Tiranë	ADR
619	Iliri Çullhaj	Fier	ABEOK	663	Jonil Gjata	Fier	PSD
620	Ilirian Ruda	Elbasan	BD	664	Jorida Kurti	Elbasan	NTH
621	Ilna Xhaferri	Elbasan	PBK	665	Josif Komino	Gjirokastër	NTH
622	Ina Veizaj	Vlorë	NTH	666	Josilda Stavri	Fier	NTH
623	Ina Begotaraj	Vlorë	NTH	667	Juel Velo	Tiranë	BD
624	Ina Tabaku	Korçë	PSD	668	Julian Zoto	Vlorë	PD-PD / AN
625	Ina Xhafer	Durrës	PLDSH	669	Julian Kodra	Korçë	PSD
626	Ina Telallari	Tiranë	PBK	670	Julian Rrista	Fier	ADR
627	Indri Hoxha	Berat	ADR	671	Juljan Mimini	Tiranë	PLDSH
628	Indrit Barruku	Durrës	PLDSH	672	Jurgen Pushi	Berat	PS
629	Ines Ranxha	Korçë	ABEOK	673	Jurgen Alla	Durrës	NTH
630	Inesa Alimadhi	Fier	PBK	674	Jurgen Salaj	Fier	PLDSH
631	Insida Kullolli	Tiranë	ABEOK	675	Jurgen Çela	Fier	PLDSH
632	Intjesa Buci	Durrës	PSD	676	Jurgen Çilotaj	Vlorë	PLDSH
633	Ira Kurti	Tiranë	ABEOK	677	Jurgen Fregjaj	Shkodër	ABEOK
634	Irena Tola	Fier	BD	678	Juri Allko	Gjirokastër	BD
635	Irena Hoxha	Shkodër	BD	679	Kadri Muka	Durrës	ABEOK
636	Irida Alimadhi	Elbasan	PBK	680	Kapllan Skuka	Dibër	BD
637	Irini Goga	Tiranë	PSD	681	Kastriot Hysaj	Elbasan	ABEOK
638	Irini Shehu	Dibër	PD-PD / AN	682	Katerina Ago	Berat	PLDSH
639	Irisa Bita	Fier	BD	683	Katerina Malo	Fier	BD
640	Islit Malo	Durrës	ABEOK	684	Kejdi Xhemollari	Korçë	BD
641	Ismail Terziu	Dibër	BD	685	Kejsi Pepa	Lezhë	NTH
642	Isuf Zeqiraj	Fier	PBK	686	Kejsi Shingjergji	Elbasan	PSD
643	Izmira Rusi(Ulqinaku)	Shkodër	PD-PD / AN	687	Kejsi Basha	Tiranë	ADR
644	Jakup Beqiri	Fier	PD-PD / AN	688	Kevi Redhaj	Tiranë	ADR
645	Jakup Shehu	Gjirokastër	PLDSH	689	Kevin Azizi	Fier	NTH
646	Jera Çapuni	Fier	PLDSH	690	Kevin Bimo	Tiranë	PLDSH
647	Jetmir Ndreu	Lezhë	PBK	691	Kevin Dodaj	Lezhë	ADR
648	Jetmira Shabani	Kukës	ABEOK	692	Kiara Gjindali	Fier	NTH
649	Jetnor Haruni	Vlorë	ABEOK	693	Kita Nova	Berat	ABEOK
650	Jetnor Dymishi	Durrës	PBK	694	Kjara Adhami	Gjirokastër	PS
651	Jetnor Hysenllari	Durrës	PBK	695	Klajdi Pllaha	Korçë	NTH
652	Jetnor Bejtaj	Vlorë	PBK	696	Klajdi Beja	Tiranë	NTH
653	Joana Qirollari	Gjirokastër	PD-PD / AN	697	Klajdi Shehu	Dibër	PLDSH
654	Joana Disha	Tiranë	BD	698	Klajdi Hajdari	Fier	PLDSH
655	Joana Karajani	Vlorë	ABEOK	699	Klajdi Toro	Fier	PBK
656	Johana Bici	Durrës	PLDSH	700	Klajdi Hida	Tiranë	PBK
657	Jolio Dine	Vlorë	PD-PD / AN	701	Klara Dervishllari	Korçë	PLDSH
658	Jona Kovaçi	Elbasan	NTH	702	Klaudia Curaj	Korçë	NTH
659	Jona Mustafa	Tiranë	BD	703	Klaudia Gega	Lezhë	NTH
660	Jonada Gjata	Tiranë	ADR	704	Klaudia Shehi	Durrës	ADR

Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti	Nr.	Emër Mbiemër	Qarku	Subjekti
705	Klaudiola Sinaj	Fier	PSD	749	Kristiana Miho	Durrës	NTH
706	Klaudjo Myftari	Vlorë	PSD	750	Kristina Saliasi	Durrës	PBK
707	Klaudjo Çobaj	Fier	PLDSH	751	Kristo Veizaj	Elbasan	ADR
708	Klaudjo Monçe	Gjirokastrë	BD	752	Kristo Evangjelu	Korçë	ADR
709	Klea Kasemi	Gjirokastrë	BD	753	Kujtim Gjuzi	Durrës	ABEOK
710	Klea Radovani	Shkodër	ADR	754	Kujtim Tota	Dibër	ABEOK
711	Klearda Rapushi	Vlorë	BD	755	Kujtim Mema	Durrës	ABEOK
712	Kledisa Çela	Korçë	NTH	756	Kujtim Lamaj	Tiranë	PBK
713	Kleida Mati	Gjirokastrë	NTH	757	Kujtim Lleshaj	Lezhë	ADR
714	Kleiton Aliaj	Vlorë	PSD	758	Laim Tota	Dibër	ABEOK
715	Klejdi Molla	Fier	PBK	759	Landi Latifi	Korçë	ABEOK
716	Kleo Murataj	Tiranë	PSD	760	Laudja Mukaj	Tiranë	PLDSH
717	Klerjan Qëndro	Fier	BD	761	Ledian Meminaj	Vlorë	BD
718	Klevin Hasekiu	Elbasan	NTH	762	Lediana Fratari	Tiranë	PD-PD / AN
719	Klevin Durraj	Fier	PSD	763	Ledio Kastrati	Fier	PD-PD / AN
720	Klevis Bahja	Elbasan	PSD	764	Ledjan Matraxhiu	Durrës	PLDSH
721	Klevis Bezati	Durrës	PLDSH	765	Ledjo Tarja	Tiranë	PLDSH
722	Klevis Çapia	Elbasan	ABEOK	766	Ledjona Kërçova	Berat	PBK
723	Klisi Haxhiraj	Vlorë	BD	767	Ledjona Kapllani	Fier	PBK
724	Klivja Doraci	Vlorë	PLDSH	768	Lefter Muskaj	Fier	PSD
725	Klodi Menalla	Elbasan	BD	769	Lejka Bonjakaj	Vlorë	ABEOK
726	Klodian Alija	Tiranë	PBK	770	Leme Hidri	Elbasan	PSD
727	Klodian Shtrezi	Tiranë	ADR	771	Lena Saliasi	Durrës	PBK
728	Klodiana Zhubi	Tiranë	NTH	772	Lenci Kapaj	Fier	PLDSH
729	Klodiana Hasanaj	Kukës	BD	773	Leonard Toçi	Elbasan	NTH
730	Klodjan Mema	Tiranë	PSD	774	Leonard Olli	Korçë	BD
731	Klodjan Troplini	Tiranë	ABEOK	775	Leonard Mema	Tiranë	ABEOK
732	Koçi Tahiri	Korçë	ADR	776	Leonida Laci	Lezhë	PBK
